




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE



Zyra e Kryetarit të Komunës

/Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029

(Me qytetarët e Komunesë së Shtimes)

Data: 19.06.2026 (e premte)

Në mbledhje morën pjesë:

- Nënkryetari i Komunës, Adnan Ademi;
- Drejtori për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti;
- Asamblistët e Kuvendit Komunal;
- Qytetarët.

Dëgjimin publik e hapi Gentiana Mehmeti nga Zyra e Kryetarit, e cila prezantoi rrjedhën e takimit.

Adnan Ademi: Faleminderit që keni gjetur kohë të vini në këtë dëgjim buxhetor, për të paraqitur shqetësimet dhe kërkesat tuaja, të cilat ne do t'i dëgjojmë dhe, sipas mundësive dhe rëndësisë, do t'i përfshijmë në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029.

Shefqet Krasniqi: Unë kam dy pyetje apo shqetësime. Sa i përket lumit, besoj që në vërshimet e para do të ketë telashe për shkak të ngushtimit të shtratit. Në Carralevë, te çerdhja, nuk është dashur të shtohet një aneks tjetër, por të ndërtohet objekt i ri, për shkak të zhurmave që krijohen në shkollë. Kur e dimë se çfarë kushtesh kërkohen për procesin edukativ të fëmijëve të vegjël, a janë marrë parasysh këto standarde?

Adnan Ademi: Sa i përket çështjes së parë, lumi është projektuar nga ekspertët, gjë që u dëshmuar edhe gjatë reshjeve të muajve të fundit, kur shumë qytete dhe fshatra u vërshuan, ndërsa nga rrjedha

e lumit Shtimjanja nuk pati vërshime të mëdha. Duhet ta keni parasysh se aktualisht janë tri kompani të ndryshme duke punuar te lumi.

Sa i përket çerdhes në Carralevë, edhe ajo është projektuar nga ekspertët dhe ky problem do të jetë i zgjidhur.

Demokrat Mujota: Është shqetësim i të gjithëve. Na keni premtuar Planin Zhvillimor Komunal. Ku jemi me këtë proces, pasi ende nuk e kemi këtë plan?

Basri Rexhaj: Unë e shoh që Shtimja po ecën me hapa shumë të mëdhenj dhe po realizohen punë që nuk janë bërë asnjëherë më parë.

Ne në Petrovë kemi votuar Vetëvendosjen, por kemi vetëm një deputet që na përfaqëson. Punët që janë bërë në Petrovë janë realizuar nga ekzekutivi, duke e ditur edhe numrin e madh të banorëve. Megjithatë, ka ende shumë hapësirë për përmirësim.

Kërkoj ndërtimin e një fushe moderne sportive te Kodra e Mullinit, si dhe rregullimin e rrugës deri te fusha, pasi ajo zonë është mjaft piktoreske.

Beqir Ahmeti: Kam disa kërkesa për fshatin Godanc, si prind i një fëmije me nevoja të veçanta. Ju përgëzoj për punët që keni bërë. Është punuar mirë, por ka ende nevojë për investime. Kanë mbetur tri rrugë pa u asfaltuar: rruga mbi xhami, rruga te Halimi dhe aneksi i rrugës Topilla, ku e kam edhe serrën time. Në atë pjesë mungon ndriçimi dhe ka dalje në rrugën kryesore. Te objekti i Hendikosit kemi bërë kërkesë për rregullimin e objektit dhe për mbështetje më të madhe për personat me nevoja të veçanta. Po ashtu, kërkojmë ndërtimin e një ure afër Besimi Commerce, ku janë të vendosura disa biznese, pasi aty ka probleme me vërshimet e ujit.

Ismet Sadiku: Jam punëtor i arsimit. Kam kërkesë për rregullimin e sallës së edukatës fizike, renovimin e shkollës, përfshirë muret, tualetet dhe klasat, si dhe rregullimin e trotuarit në lagjen e Gjinocëve. Po ashtu, dua të ndërlihem me çështjen e çerdhes në Carralevë. Si pedagog, konsideroj se ajo nuk paraqet problem dhe se i plotëson kushtet e nevojshme.

Nexhmedin Sylja: Shumë pak po përmendet Reçaku. Ka nevojë të rregullohet ura e Ramadan Hysenit, kanalizimi i shkollës dhe të ndërtohet një park. Pyetja ime kryesore është: kur do të fillojnë punimet në Kompleksin Memorial të Reçakut?

Naim Zejna: Vij këtu si përfaqësues i lagjes Komandant Kumanova. Dua të ndërlihem me projektin e lumit Shtimjanja. Te ura e vjetër, siç e quajmë ne, është realizuar një projekt i mirë. Kërkesa ime është që edhe segmenti i lumit pranë urës të përfshihet në projekt.

Po ashtu, kërkoj që të zvogëlohet harku i urës, pasi e rëndon pamjen dhe e kufizon dukshmërinë.

Fatlinda Rrafshi: Kam kërkesë nga banorët e fshatit Petrovë për rregullimin e ndriçimit në lagjen Gjyteti.

Idriz Neziraj Përshëndetje. Kam kërkesë për ndërtimin e kanalizimit në rrugën Komandant Kumanova, afër Liqenit të Mjellmave, si dhe për sigurimin e transportit për nxënësit.

Sabri Krasniqi: Përshëndetje. Pavarësisht punëve të mira që po realizohen, ende ka nevojë për investime të tjera. Sa i përket fshatit Dugë, problemi kryesor që duhet të zgjidhet me prioritet është emërtimi i rrugëve. Shumë banorë dëshirojnë të investojnë në agroturizëm, por vizitorët e kanë të vështirë t'i gjejnë lokacionet për shkak të mungesës së adresave dhe emërtimeve zyrtare. Po ashtu, në projektin e ujësjellësit për Pjetërshticë mund të përfshihen edhe Dugë dhe Karaçicë. Te Kroi i Dugës, që është një shenjë identifikuese e trashëguar nga të parët tanë, kërkojmë vendosjen e tri dritave.

Fatmir Misini: Përshëndetje. Kam kërkesë për Lagjen e Pajtimit, në rrugën "Çamëria", për asfaltimin e rrugicës së parë, si dhe për rregullimin e kanalizimit në vendin ku dikur ka qenë ferma.

Qamil Krasniqi: Përshëndetje, jam nga Karaçica. Banorët kanë filluar të kthehen, gjë që është me rëndësi edhe për komunën. Kam kërkesa për disa rrugica, për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike, pasi rrjeti është shumë i dobët, si dhe për asfaltimin e tri rrugëve në lagjen Kelmendi. Gjithashtu, kërkoj asfaltimin e dy segmenteve në rrugën Krasniqi dhe shtrimin me zhavorr të disa rrugëve të tjera.

Haqif Arifi Kam vetëm një pyetje: A do të publikohen të gjitha projektet, operatorët dhe vlerat financiare të projekteve?

Egzona Selmani Përshëndetje për të gjithë. Kam kërkesë që të bëhet ndriçimi në lagjen Gjyteti, pasi frekuentohet shumë nga banorët. Gjithashtu, kërkoj që të zgjerohet rruga te pjesa e urës në rrugën "Mejdi Korani" ose, së paku, të vendoset sinjalizim adekuat, pasi ajo pjesë është shumë e rrezikshme.

Adnan Ademi: Ju falënderoj sinqerisht për kohën që ndatë për të marrë pjesë në këtë dëgjim publik, për kontributin tuaj, sugjerimet, vërejtjet dhe kërkesat që i paraqitët gjatë këtij takimi. Pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme për ne, sepse na ndihmon që planifikimet dhe prioritetet e komunës të jenë sa më afër nevojave reale të qytetarëve. Të gjitha kërkesat dhe propozimet e paraqitura do të shqyrtohen me kujdes nga institucionet komunale dhe, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe prioritetet zhvillimore, do të trajtohen në procesin e planifikimit të Komizës Afatmesme Buxhetore.

Ju falënderoj edhe një herë për bashkëpunimin, angazhimin dhe interesimin tuaj për zhvillimin e komunës sonë. Shpresoj që edhe në të ardhmen të vazhdojmë këtë komunikim dhe bashkëpunim të ndërsjellë në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Mirupafshim dhe shihemi në takimet e ardhshme.



Procesmbajtëse: Vlora Hyseni